

VENDIM
Nr. 774, datë 4.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 128, DATË 13.3.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË, TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2019", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 3, dhe 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", të ndryshuar, dhe të shkronjës "a", të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 128, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, në shkronjën "a", vlera "495 000 000 (katërqind e nëntëdhjetë e pesë milionë) lekë" zëvendësohet me "551 992 000 (pesëqind e pesëdhjetë e një milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë", ndërsa në shkronjën "c", vlera "84 000 000 (tetëdhjetë e katër milionë) lekë" zëvendësohet me "284 000 000 (dyqind e tetëdhjetë e katër milionë) lekë".

b) Në pikën 6, në shkronjën "a", vlera "83 000 000 (tetëdhjetë e tre milionë) lekë" zëvendësohet me "74 243 822 (shtatëdhjetë e katër milionë e dyqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e njëzet e dy) lekë", ndërsa në shkronjën "b", vlera "2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë" zëvendësohet me "1 779 800 (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) lekë".

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe